



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHOQËRIA RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME FIER SH.A

Nr. _____ prot

Fier, më _____ / _____ /2026

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT, PAS PUBLIKIMIT TË TË CILIT FILLOJNË
AFATET E ANKIMIMIT**

Data 17.07.2026

Drejtuar: Operatorit Ekonomikë

"BALILI KONSTRUKSION" SHPK, me NIPT K17016202S
Me Adrese Vlore, Velce

Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë (BOE) ☐

- OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐

JO X ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO X ☒

JO ☐

"ED KONSTRUKSION" SHPK, me K61625001I

Me Adrese Kryqezimi i Rruges Liman Kaba me Prokop Mima, Rezidenca Olimpik, shkalla nr.2, kati i 4, Tirane

*** * ***

Tipi i Kontratës: Sherbim

Lloji i Procedurës së prokurimit: E Hapur, Sherbim

Numri i Procedurës / referenca e Lotit: **REF-86909-05-25-2026**

1. Përshkrimi i shkurtër i kontratës: *Ndërtim Rrjet Ujësjellësi për Zonën DMA 10, Bashkia Fier*

me fond limit prej **109.297.285** (njëqind e nente milion e dyqind e nentëdhjetë e shtatë mijë e dyqind tetëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH, me burim financimi nga Buxheti i Shtetit, në përputhje me sasi të, specifikimet teknike, termat e referencës dhe kushtet e përcaktuara në DST.

Objekti i prokurimit do të prokurohet, kontraktohet dhe zbatohet (lëvrohet), me vlerë dhe sasi të plotë brenda afatit të lëvrimin.

Afati kohor për ekzekutimin e kontratës: **jo më vonë se 4(kater) muaj nga data e lidhjes së kontratës.**

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në SPE: 26.05.2026

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në Buletin e Njoftimeve Publike [Nr.35, datë 01 Qershor 2026].

KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:

- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto ☐
- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim **X** ☐

Me anë të këtij Formulari ju informojmë se, në këtë procedurë/lot kanë marrë pjesë, Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik **"BALILI KONSTRUKSION" SHPK**, me **NIPT K17016202S SHPK**, **me Subjekt Mbështetës ED KONSTRUKSION" SHPK**, me **K61625001I** ka ofruar për këtë tender vlerën ekonomike në total **99.908.465.16** (*nentedhjete e nente milion e nenteqind e tete mije e katerqin e gjashtedhjete e pese pike gjashtembedhjete*) **lekë pa TVSH**, me çmime të paraqitura sipas shtojcës 1 por nuk ka paraqitur asnje dokumentacion tjetër.
2. Operatori Ekonomik **"NDREGJONI" SHPK** me **NIPT K31329048I** ka ofruar për këtë tender vlerën ekonomike në total **73.761.412** (*shtatedhjete e tre milion e shtateqind e gjashtedhjete e e nje mije e katerqind e dymbedhjete*) **lekë pa TVSH**, me çmime të paraqitura sipas shtojcës 1 por nuk ka paraqitur asnje dokumentacion tjetër.
3. Operatori Ekonomik **"2 N" SHPK** me **NIPT L31615017L me Subjekt Mbështetës "BONUS" SHPK**, **Me NIPT K72412009E**, **"AVDULI" SHPK ME NIPT J66703306O**, ka ofruar për këtë tender vlerën ekonomike në total **79.966.955** (*shtatedhjete e nente milion e nenteqind e gjashtedhjete e gjashte mije e nenteqind e pesedhjete e pese*) **lekë pa TVSH**, me çmime të paraqitura sipas shtojcës 1 por nuk ka paraqitur asnje dokumentacion tjetër.
4. Operatori Ekonomik **"ARKONSTUDIO" SHPK** me **NIPT L42019004I** ka ofruar për këtë tender vlerën ekonomike në total **106.019.458.51** (*njeqind e gjashte milion e nentembedhjete mije e katerqind e pesedhjete e tete pike pesedhjete e nje*) **lekë pa TVSH**, me çmime të paraqitura sipas shtojcës 1 por nuk ka paraqitur asnje dokumentacion tjetër.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐

JO **X** ☐

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar , Ofertuesat i meposhtem:

1. Operatori Ekonomik **"NDREGJONI" SHPK** me **NIPT K31329048I**, per arsye se nuk ploteson piken 2.3.4, 2.3.9, 2.3.11, te kapacitet teknike DST.

2.3.4. Operatori ekonomik ofertues, me anë të një deklarate (nga Administratori i shoqërisë) duhet të përcaktojë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt.

Pra, në kriteret e kualifikimit kërkohet që të deklarohet se Drejtuesi teknik nuk është i angazhuar në kontrata të tjera.

Për plotësimin e këtij kriteri Ju keni dorëzuar në SPE, Deklaratë për Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, ku shpreheni se:

Unë i nënshkruari Xhetan Ndregjoni me cilësinë e administrator të operatorit ekonomik NDREGJONI sh.p.k deklaroj ne pergjegjesine time te plote se: Z. P.D, me profesion Inxhinier Ndërtimi dhe i përfshirë në licencën e shoqërisë, do të ushtrojë detyrën e drejtuesit teknik të punimeve në objekt, sipas profilit përkatës. Ai do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës së kryerjes së punimeve, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.

Shifet qartësisht se në rastin konkret në përputhje me Vendimi Nr. 448, datë 31.7.2025 “Për miratimin e rregullores së zbatimit të punimeve të ndërtimit dhe të rregullave të kantierit”, autoriteti ka përcaktuar se Drejtuesi Teknik i punimeve në objekt, të jetë në licensën e shoqërisë si dhe të mos jetë i angazhuar në kontrata të tjera.

Siç, shifet dhe në kriterin e kualifikimit nga autoriteti kontraktor është përcaktuar shprehimisht se drejtuesi Teknik i punimeve në objekt, nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera.

Referuar, deklarimit të bërë nga operatori ekonomik “Ndregjoni” shpk, në deklaratën e cila diponohet në SPE, nuk ka deklaruar që ing.P.D nuk është i angazhuar në kontrata të tjera, cka bien në kundërshtim me kriteret për kualifikim të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit

Sa më sipër, ju nuk plotësoni kriterin e kualifikimit mbi pikën 2.3.4

Gjithshtu, ju nuk plotësoni kriterin e vecantë të kualifikimit 2.3.9 mbi Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 8).

Referuar dokuemtacionit të kërkuar për plotëimin e dokuemtacionit mbi mjetet dhe pajisjet e nevojshme për realizimin e objektit të kontratës ku ndër të tjera është kërkuar disponimi i tyre nëpërmjet dokuemtacionit si më poshtë vijon:

Për mjetet me qera, të paraqiten dokumentet e mesiperme që vërteton pronësinë e mjetit (certifikatë pronësie), dokument që vërteton rregjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), certifikata e kontrollit teknik SGS si dhe siguracionin e mjetit (policë sigurimi); të vlefshme dhe keto dokumente duhet të shoqërohen me kontratën përkatëse të qerasë noteriale të vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi.

Për mjetet e tjera që nuk janë të shënuara në rregjistra publike duhet të paraqitet kontratë noteriale e blerjes / faturë tatimore / dokument zhdoganimi të mjetit. Për pajisjet në pronësi shoqërohen me akt pronësie origjinal ose fotokopje të noterizuar (kontrata shitblerje, kontrata dhurimi, fatura tatimore shitje, deklaratë zhdoganimi), të vlefshme. Për pajisjet me qera të paraqitet kontrata e lidhur para noterit për këtë objekt shoqëruar me akt pronësie origjinal ose fotokopje të noterizuar (kontrata shit-blerje, kontrata dhurimi, fatura tatimore shitje, deklaratë zhdoganimi), të vlefshme.

Në shtojcën 8, Formulari i Vetdeklarimit, për mjetet Plankola, Trench Box dhe Sonde me kamer inspektimi të tubave, kontratat e qerasë për këto mjete dhe pajisje, nuk janë të lidhura para noterit sipas përcaktimit të DST.

Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.

Nëse do të kishit pretendime në lidhje me kriteret e vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, keni pasur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës lidhur me kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit, parashikuar nga neni 110 pika 1 e ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” në të cilin parashikohet se “1. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të kontratës ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.”

Gjithashtu, kuadri ligjor parashikon një sërë elementësh si garanci për operatorët ekonomikë, të cilët kanë paqartësi në lidhje me interpretimin e kërkesave të autoritetit kontraktor dhe/ose mënyrës së plotësimit të kriterëve kualifikuese. Në rast se operatori ekonomik do të kishte paqartësi në lidhje me plotësimin e kërkesës së mësipërme, ka pasur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në gjashtë ditë para dorëzimit të ofertave parashikuar nga pika 1 e nenit 75 të LPP-së ku përcaktohet se “1.

Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti ose enti kontraktor, i cili duhet t'i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 6 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor ose enti duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t'ua komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit. Në çdo rast, sqarimi i dokumenteve të tenderit nuk do të konsiderohet shtim, pakësim ose ndryshim i kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit. Sa më sipër, nuk plotëson kriterin e kualifikimit mbi dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike dhe oferta juaj s'kualifikohet.

Gjithashtu, shoqëria juaj nuk plotëson kriterin e kualifikimit mbi kriterin e vecantë të kualifikimit 2.3.11 ku përcaktohet se:

2.3.11 Në përputhje me kërkesat dhe përmasat e publikuara nga Autoriteti Kontraktor në specifikimet teknike dhe preventiv, për listën e artikujve, si më poshtë:

- Tuba ujësjellësi PE
- Saraqineska, Rakoderi elektrofuzive
- Mates multijet
- Valvula PE

Operatori ekonomik duhet të paraqesë:

Autorizim të Prodhuesit/ve ose autorizim nga Distributori i autorizuar prej Prodhuesit ose Marrëveshje bashkëpunimi të zyrtarizuar, e cila të tregojë lidhjen midis ofertuesit dhe prodhuesit ose midis ofertues distributor-prodhues për listën e mësipërme të mallrave. Autorizimi / Marrëveshja e bashkëpunimit duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: Telefon, fax, e-mail, ëbsite, e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij, si dhe të jetë e vlefshme deri në realizimin e plotë të punimeve.

Në rast të disponimit të autorizimit të prodhuesit në gjuhë të huaj, ky dokument të paraqitet i përkthyer dhe i noterizuar në gjuhën zyrtare shqipe.

- Katalogun / et ose fragmente të katalogut/eve të prodhuesit / ve për listën e mësipërme të artikujve në të cilët të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen.
- Shënim: Fragmentet e Katalogut / ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë që janë pjesë katalogu, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i përkasin.
- Të gjitha materialet e mësipërme duhet të jenë sipas Standarteve Europiane të pajisura me certifikatë Konformiteti ose deklaratë konformiteti CE.

- Tuba Ujësjellësi PE

Operatori Ekonomik të paraqesë certifikatë aprovimi e leshuar nga një Institucion Ndërkombëtar ose Kombëtar, i Akredituar që verteton përdorimin e tyre për ujin e pijshëm.

- Matsat multijet

Operatori Ekonomik të paraqesë certifikatë MID, e leshuar nga një Institucion Ndërkombëtar ose Kombëtar, i Akredituar.

- Valvula PE

Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatë e leshuar nga një Institucion Ndërkombëtar ose Kombëtar, i Akredituar që verteton se produkti është për përdorim për ujësjellës.

Në shqyrtim të dokumentacionit të paraqitur nga ana juaj për plotësimin e kriterit për artikullin Tuba Ujësjellësi PE, ju keni paraqitur certifikatë aprovimi të leshuar nga një Institucion Ndërkombëtar ose Kombëtar, i Akredituar që verteton përdorimin e tyre për ujin e pijshëm, me afat skadence Dhjetor 2022.

Sa më sipër, dokumentacioni i paraqitur për tuba Tuba Ujësjellësi PE, nuk është në përputhje me kriteret e kualifikimit dhe oferta juaj s'kualifikohet.

Për artikullin Matsat multijet, nuk keni paraqitur dokumentacion mbi plotësimin e kriterit mbi paraqitjen e një certifikatë MID, e leshuar nga një Institucion Ndërkombëtar ose Kombëtar, i Akredituar.

Për artikullin Valvula PE , nuk keni paraqitur dokumentacion mbi plotësimin e kriterit mbi paraqitjen e nje certifikatë të lëshuar nga një Institucion Ndërkombëtar ose Kombëtar, i Akredituar qe verteton se produkti është për përdorim për ujësjellës.

Gjithashtu, në katalogun e paraqitur për Valvula PE, katalogu i paraqitur në SPE nuk plotësohen specifikimet teknike të kërkuara dhe i përkasin specifikimeve teknike jo të artikullit të kërkuar nga Autoriteti kontraktor.

Dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “Ndregjoni“ shpk, në procedurën e prokurimit, nuk plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe nuk mund të konsiderohet i vlefshëm.

2.Operatori Ekonomik “ARKONSTUDIO” SHPK me NIPT L42019004I, per arsye se nuk ploteson piken 2.3.8, 2.3.9, te kapacitet teknike ne DST dhe konkretisht:

Ne piken 2.3.8 Kerkohet konkretisht :

2.3.8 Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf teknik për kryerjen e punimeve, të vërtetuar me kontratë punë të vlefshme, diplomë/dëshmi përkatëse lëshuar nga institucione te akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik (të vlefshme) lëshuar nga Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për çertifikimin e punonjësve, si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi per 3 (tre) muajt e fundit te deklaruar nga data e hapjes së ofertave, si më poshtë:

a) Staf teknik

- Teknik Ndërtimi 1(një)
- Hidraulikë 2 (dy)
- Hidroizolues 1 (një)
- Suvatues 1(një)
- Karpentier 1(një)
- Hekurkthyes 2 (dy)
- Shofer 2 (dy)
- Puntore të thjeshtë 5 (pesë)

b) Punonjes Manovrator

a. Eskavatorist 2 (një)

b. Automakinist 1 (një)

Bazuar ne dokumentacionin e ngarkuar nga ana juaj , konkretisht ne shtojcen numer 8 ju bejme me dije se keni mangesi per stafin teknik qe keni deklaruar :

- Suvatues
- Hekurthyes (mungon 1)
- Puntore te thjeshte
- Automakinist

Ne piken 2.3.9 Kerkohet konkretisht :

2.3.9 Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 8) konkretisht:

Nr Lloji i Makinerive Statusi Sasia

- 1 Kamionçina me kapacitet mbajtës deri në 3.5 ton Pronesi ose me qira 1 copë
- 2 Kamion vetshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 20 ton Pronesi ose me qira 1 copë
- 3 Kamion vetshkarkues me kapacitet mbajtës (10 – 15) ton. Pronesi ose me qira 1 copë
- 4 Eskavator me goma me targa Pronesi ose me qira 2 copë
- 5 Ekskavator me zinxhire me peshe jo me te vogel se 20 ton i pajisur me matrapik per prishje struktura Pronesi ose me qira 1 copë
- 6 Ekskavator me zinxhire Pronesi ose me qira 1 copë
- 7 Rrul vibrues me goma Pronesi ose me qira 1 copë
- 8 Autobetoniere kantieri vetngarkuese me peshe jo me te vogel se 5 ton Pronesi ose me qira 1 copë

- 9 Dumper kantieri vetshkarkues me peshe jo me te vogel se 2.5 ton me targa Pronesi ose me qira 1 copë
- 10 Rimorkiator per levizjen e makinerive te ndertimit me kapacitet mbajtese jo me pak se 20 ton Pronesi ose me qira 1 copë
- 11 Makine per shpime horizontale te drejtuara (HDD) Pronesi ose me qira 1 copë
- 12 Palankola Pronesi ose me qira 2000 kg
- 13 Trench Box Pronesi ose me qira 5 copë
- 14 Vibrator te jashtem Pronesi ose me qira 2 cope
- 15 Matrapik me benzine Pronesi ose me qira 1 copë
- 16 Instrument Topografik (Stacion Total, GPS) Pronesi ose me qira 1 copë
- 17 Vibrator hidraulik me force vibruese jo me pak se 464 Kn Pronesi ose me qira 2 copë
- 18 Pompe uji Pronesi ose me qira 1 copë
- 19 Matrapik Pronesi ose me qira 1 copë
- 20 Kalleperi (betoforma) Pronesi ose me qira 500m2
- 21 Gjenerator / Motogjenerator Pronesi ose me qira 1 copë
- 22 Autobetoniere Pronesi ose me qira 1 copë
- 23 Prerese asfalti Pronesi ose me qira 1 copë
- 24 Asfaltoshtruese Pronesi ose me qira 1 copë
- 25 Kontenier per zyre kantieri Pronesi ose me qira 1 copë
- 26 Sistem well point e pajisur me age, kolektor mbledhes dhe pompe thithese perkatese per thithjen e ujerave nentokesore Pronesi ose me qira 1 copë
- 27 Aparaturë për bashkim tubacionesh me metodën “Elektro Fusion” Pronesi ose me qira 1 copë
- 28 Aparat saldimi për ngjitje të tubave koke me koke Pronesi ose me qira 1 copë
- 29 Pajsje per testimin e tubave Pronesi ose me qira 1 copë
- 30 Sonde me kamer per inspektimin e tubave Pronesi ose me qira 1 copë
- 31 Dedektor rrjetesh Pronesi ose me qira 1 copë
- Mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit në zbatim të kërkesave të VKM Nr. 312 datë 05.05.2010 “Për miratimin e Rregullores për sigurinë në kantier”, si më poshtë vijon:

Nr Mjete mbrojtese Njesia Sasia

- 1 Kuti e ndihmes se shpejte cope 1 copë
- 2 Tabela sinjalistike e perkohshme per menaxhim trafiku cope 10 copë
- 3 Helmeta pune, kokore cope 35 copë
- 4 Jelek pune fosforeshent cope 35 copë
- 5 Fikëse zjarri të lëvizshme cope 5 copë

Ju nuk plotësoni kriterin e kualifikimit 2.3.9 Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, pasi keni mangësi fizike të dokumentacionit të kërkuar. Mjetet dhe pajisjet e punes qe mungojne nga vetedeklarimi ne shtojcen 8 :

Nr Lloji i Makinerive Statusi Sasia

- 3 Kamion vetshkarkues me kapacitet mbajtes (10 – 15) ton. Pronesi ose me qira 1 copë*
- 4 Eskavator me goma me targa Pronesi ose me qira 2 copë*
- 5 Ekskavator me zinxhire me peshe jo me te vogel se 20 ton i pajisur me matrapik per prishje struktura Pronesi ose me qira 1 copë*
- 7 Rrul vibrues me goma Pronesi ose me qira 1 copë*
- 10 Rimorkiator per levizjen e makinerive te ndertimit me kapacitet mbajtese jo me pak se 20 ton Pronesi ose me qira 1 copë*
- 11 Makine per shpime horizontale te drejtuara (HDD) Pronesi ose me qira 1 copë*
- 12 Palankola Pronesi ose me qira 2000 kg*
- 13 Trench Box Pronesi ose me qira 5 copë*
- 14 Vibrator te jashtem Pronesi ose me qira 2 cope*
- 15 Matrapik me benzine Pronesi ose me qira 1 copë*
- 16 Instrument Topografik (Stacion Total, GPS) Pronesi ose me qira 1 copë*
- 17 Vibrator hidraulik me force vibruese jo me pak se 464 Kn Pronesi ose me qira 2 copë*
- 18 Pompe uji Pronesi ose me qira 1 copë*
- 20 Kalleperi (betoforma) Pronesi ose me qira 500m2*

- 25 Kontenier per zyre kantieri Pronesi ose me qera 1 copë
- 26 Sistem well point e pajisur me age, kolektor mbledhes dhe pompe thithese perkatese per thithjen e ujerave nentokesore Pronesi ose me qera 1 copë
- 27 Aparaturë për bashkim tubacionesh me metodën “Elektro Fusion” Pronesi ose me qera 1 copë
- 28 Aparat saldimi për ngjitje të tubave koke me koke Pronesi ose me qera 1 copë
- 29 Pajisje per testimin e tubavce Pronesi ose me qera 1 copë
- 30 Sonde me kamer per inspektimin e tubave Pronesi ose me qera 1 copë
- 31 Dedektor rrjetesh Pronesi ose me qera 1 copë

3.Operatori Ekonomik “2 N” SHPK me NIPT L31615017L, per arsye se nuk ploteson piken 2.3.8, 2.3.1, 2.3.2, 2.3.9, 2.3.11, te kapacitet teknike ne DST.

Në kriteret e kualifikimit për realizimin, ekzekutimin e kontratës objekt prokurimi ndër të tjera është kërkuar:

12 Palankola Pronesi ose me qira 2000 kg

Në përmbushje të kriterëve të kualifikimit, referuar në shtojcën 8 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, ju keni deklaruar si më poshtë:

palankoma 200 Kg Nr REF. Doganbore :84824 date 12.12.2014

Sa më sipër, operatori ekonomik ka managësi në përmbushjen e kriterit mbi mjetet dhe pasjet teknike. Pra, Ju nuk plotësoni kriterin 2.3.9, pasi nuk plotësoni sasinë e palankolave të kërkuara në këtë procedurë prokurimi, nga 2000 kg palankola të kërkuara sipas kriterëve të vecanta të kualifikimit nga autoriteti kontraktor, ju keni deklaruar se dipononi vetëm 200 kg.

Në rastin konkret, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron kapacitetet teknike (makineritë/pajisjet), në përputhje me volumin e përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Autoriteti kontraktor, komsioni i vlerësimit të ofertave do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit.

Për pasojë, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa.

Komisioni i vlerësimit, konstaton, se operatori ekonomik “2N” SHPK nuk plotëson kriterin e veçantë të kualifikimit, pasi ka paraqitur shtojcën 8, tregon qartësisht se nuk ka përmbushur “Kriteret e të veçanta të kualifikimit mbi dëshmi për mjetet dhe pasjet teknike pjesë e dokumenteve të tenderit për palangola 2000 kg.

Sa më sipër, shoqëria juaj s'kualifikohet.

Së dyti, operatori ekonomik “2N” shpk, nuk plotëson kriterin e kualifikimit mbi 2.3.11 të DST.

Në kriteret e vecanta të kualifikimit pika 2.3.11 përcaktohet se:

2.3.11 Në përputhje me kërkesat dhe përmasat e publikuara nga Autoriteti Kontraktor në specifikimet teknike dhe preventiv, për listën e artikujve, si më poshtë:

- Tuba ujësjellësi PE
- Saraqineska, Rakoderi elektrofuzive
- Mates multijet
- Valvula PE

Operatori ekonomik duhet te paraqese:

Autorizim të Prodhuesit/ve ose autorizim nga Distributori i autorizuar prej Prodhuesit ose Marrëveshje bashkëpunimi të zyrtarizuar, e cila të tregojë lidhjen midis ofertuesit dhe prodhuesit ose midis ofertues distributor-prodhues për listën e mësipërme të mallrave. Autorizimi / Marrëveshja e bashkëpunimit

duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: Telefon, fax, e-mail, ëbsite, e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij, si dhe të jetë e vlefshme deri në realizimin e plotë të punimeve.

Në rast të disponimit të autorizimit të prodhuesit në gjuhë të huaj, ky dokument të paraqitet i përkthyer dhe i noterizuar në gjuhën zyrtare shqipe.

- Katalogun / et ose fragmente të katalogut/eve të prodhuesit / ve për listën e mësipërme të artikujve në të cilët të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen.

- Shënim: Fragmentet e Katalogut / ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë që janë pjesë katalogu, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i përkasin.

- Të gjitha materialet e mësipërme duhet të jenë sipas Standarteve Europiane të pajisura me certifikatë Konformiteti ose deklarata konformiteti CE.

- Tuba Ujësjiellësi PE

Operatori Ekonomik të paraqesë certifikatë aprovimi e leshuar nga një Institucion Ndërkombëtar ose Kombëtar, i Akredituar që verteton përdorimin e tyre për ujin e pijshëm.

- Matsat multijet

Operatori Ekonomik të paraqesë certifikatë MID, e leshuar nga një Institucion Ndërkombëtar ose Kombëtar, i Akredituar.

- Valvula PE

Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatë e leshuar nga një Institucion Ndërkombëtar ose Kombëtar, i Akredituar që verteton se produkti është për përdorim për ujësjellës.

Në dokumentat standarde të tenderit pika 4.7:

4.7 Gjuha (ët) në të cilat mund të hartohen ofertat:

Shqip Xð Anglishtð

Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, operatori ekonomik 2N shpk, në përmbushje të kriterëve sa më sipër, ka dorëzuar:

- Autorizim nga KUZHEY BORU ne gjuhe te huaj
- Autorizim nga ALIAXIS Hungary SEE Kft. ne gjuhe te huaj
- Katalog nga ALIAXIS Hungary SEE Kft. ne gjuhe te huaj
- CE Nga KUZHEY BORU ne gjuhe te huaj
- CE Nga B.METERS ne gjuhe te huaj
- Certifikatat DVGË ne gjuhe te huaj
- Etj...

Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt-prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë për produktet që do të ofrojnë, e rrjedhimisht është e drejtë e këtij të fundit t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatat e cilësisë.

Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, me dokumentacionin e dorëzuar, duhet të vërtetojnë, që produkti i ofruar është në përputhje me parametrat dhe specifikimet teknike e kërkuara nga autoriteti kontraktor.

Operatorët ekonomikë ofertues marrin përsipër përmbushjen e specifikimeve teknike/ kriterëve të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga ana e autoriteteve kontraktore, nëpërmjet deklaratave dhe dokumentacionit provues në të cilin duhet të faktojnë përputhshmërinë e dokumentacionit me kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në mënyrë që nga ana e këtij të fundit të mund të kryhet me lehtësi e saktësi vlerësimi i mallrave apo shërbimeve të ofertuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duke përzgjedhur atë ofertues, i cili me dokumentacionin e dorëzuar garanton përputhshmërinë me kriteret e përcaktuara në DT, e rrjedhimisht realizimin me sukses të kontratës objekt – prokurimi.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga operatori ekonomik 2N shpk, në SPE, konstaton se të gjithë autorizimet, katalogët, certifikatat CE, pra gjithë dokumentacioni i paraqitur nga ky operator për plotësimin e pikës 2.3.11, nuk është i përkthyer në gjuhën shqip.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave thekson faktin se, procedura e prokurimit është “Procedurë e hapur”.

Referuar pikës 2 të neni 24 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave për

prokurimin publik”, i ndryshuar ku parashikohet shprehimisht se: “2. Në rastin e procedurave të prokurimit mbi kufijtë e lartë monetarë, dokumentet e tenderit duhet të hartohen në gjuhët shqip dhe anglisht. Operatorët ekonomikë mund të paraqesin ofertat e tyre në gjuhët shqip ose anglisht. Në procedurat e prokurimit nën kufijtë e lartë monetarë, gjuha e përdorur është gjuha shqipe. Në këto procedura, në raste specifike, nëse autoriteti/enti kontraktor e gjykon të nevojshme, mund të hartojë dokumentet e tenderit në gjuhët shqip dhe anglisht dhe njofton operatorët ekonomikë se mund të paraqesin ofertat e tyre në gjuhët shqip ose anglisht.”.

Në këto kushte Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjykon se, duke qenë se procedura e prokurimit objekt ankimi është procedurë nën kufirin e lartë monetar, ligjvënësi ka përcaktuar se gjuha e prokurimit e përdorur është gjuha shqip dhe rrjedhimisht dhe oferta e dorëzuar duhet ti përmbahet gjuhës së prokurimit.

Përkufizimi ligjor i mësipërm është gjithpërfshirës, pra për të gjithë dokumentacionin përkatës, që paraqitet në këtë procedurë prokurimi.

Në kushtet kur, në dokumentet e tenderit të hartuara e të miratuara nga Agjencia e Prokurimit Publik, e konkretisht në kriteret e përgjithshme të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë, si dhe nuk duhet të ndryshohen për asnjë arsye nga autoriteti kontraktor gjatë hartimit të dokumenteve të tenderit, është përcaktuar qartësisht se “Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe” në këtë kuadër, i gjithë dokumentacioni i paraqitur në procedurën e prokurimit në sistem elektronik duhet të jetë në gjuhën shqipe ose i shoqëruar me përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Gjithashtu, duke u referuar në DST e procedurës konkretisht në kreun “Udhëzime për operatorët ekonomikë” Seksioni 1, “B Përgatitja e ofertave” pika 2 “Gjuha e ofertës” ku përcaktohet se: Oferta, si dhe të gjitha korrespondencat dhe dokumentet në lidhje me procedurën e prokurimit do të paraqiten në gjuhën/gjuhët e specifikuar në njoftimin e kontratës.

Dokumentet mbështetëse dhe literatura e printuar që janë pjesë e Ofertës mund të jenë në një gjuhë tjetër me kusht që ato të shoqërohen nga një përkthim zyrtar i fragmenteve përkatëse në gjuhën e specifikuar në njoftim”, duhet që të gjithë dokumentet e paraqitura në rrugë elektronike të jenë në gjuhën shqipe siç autoriteti kontraktor ka përcaktuar në njoftimin e kontratës ose nëse janë në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastin konkret në sistemin e prokurimit elektronik, operatori ekonomik 2N Shpk, ka paraqitur, në gjuhë të huaj, Autorizimet, katalogët, certifikata aprovimi pra, gjithë dokumentacionin e sipërcituar për plotësimin e kriterit 2.3.11 të pashoqëruar me përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe në kundërshtim me atë që autoriteti kontraktor ka përcaktuar në përmbajtjen e dokumenteve të tenderit.

Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente do të refuzohen si të papranueshme.

Referuar, sa më sipër, operatori ekonomik “2N” shpk, nuk plotëson kriterin 2.3.11 në përputhje me DST, pasi dokumentacioni i dorëzuar duhet të ishte përkthyer në gjuhën shqip në përputhje me parashikimet e rregullave të prokurimit publik.

Praktikë e njëjtë ligjore është dhe V E N D I M Nr. 353/2026, datë 05.03.2026, i Komisionit të Prokurimit Publik. (faqe 36 deri në 40)

Në të përcaktohet saktësisht që vendimarrja jonë është në përputhje të legjilacionit të prokurimit publik, por dhe të vendimeve të njëjta dhe praktikave ligjore konsoliduara tashmë dhe të ndjekura dhe nga Komisioni i Prokurimit Publik.

Akoma me tej, operatori ekonomik nëpërmjet dokumentacionit të dorëzuar në SPE, ka deklarur se nuk plotëson të kriterit sipas përcaktimeve të dokumentave të tenderit, pra ka pranuar mosplotësimin e kriterit të kualifikimit

Në SPE, operatori ekonomik “2N” shpk deklaroi se:

Për disa prej dokumenteve të paraqitura në ofertën tonë, konkretisht autorizimet e prodhuesit, certifikatat, deklaratat ose dokumente të tjera mbështetëse të lëshuara nga subjekte të huaja, dokumentacioni origjinal është hartuar dhe lëshuar në gjuhë të huaj nga institucionet apo prodhuesit përkatës. Për shkak të volumit të dokumentacionit dhe kohës së nevojshme për kryerjen e procedurave të përkthimit dhe noterizimit, këto dokumente do të ngarkohen në Sistemin Elektronik të Prokurimit në

formën e tyre origjinale, të lëshuara nga autoritetet ose subjektet përkatëse.

Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

Pra, operatori ekonomik “2N” shpk, pranon se dokumentacioni i dorëzuar në SPE për plotësimin e kriterit 2.3.11, nuk është i shoqëruar me përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe sipas përcaktimeve ligjore në fuqi.

Sa më sipër, shoqëria juaj s'kualifikohet.

Akoma me tej, edhe në një verifikim të dokumentacionit të dorëzuar anglisht jo me përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe, konstatohet se operatori ekonomik, për tubat ujësjells PE, nuk ka paraqitur katalog të KUZEYBORU, për artikullin Rakorderi EF, mungon Autorizim Prodhuesi, është paraqitur vetëm autorim distributori.

Pra, sa më sipër edhe në supozimin se ky dokumentacioni do ishte paraqitur në përputhje me kriterin e përgjithshëm të kualifikimit në gjuhën shqipe sërish operatori ekonomik 2N shpk, nuk do të plotësonte kriterin e kualifikimit 2.3.11.

Së treti, shoqëria juaj nuk plotëson kriteret e kualifikimit mbi pikën 2.3.1 të Kapacitet Teknik të DST ku përcaktohet se:

2.3 Kapaciteti teknik:

Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e si më poshtë:

2.3.1 Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

Punë të ngjashme për një objekt të vetëm, me vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet, konkretisht: 54 648 642.5 (pesedhjetë e kater milion gjashtëqind e dyzete e tete mije e gjashtëqinde dyzete e dy pike pese) lekë pa TVSH të realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

a) Punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është në një vlerë jo më të vogël sa dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet konkretisht: 218 594 570 (dyqind e tetëmbeshjetë milion e peseqind e nentëdhjetë e kater mije e peseqind e shtatëdhjetë mije) lekë pa TVSH.

Plotesimi i njerit prej dy kushteve të siperpermendura e ben oferten te kualifikueshme.

***Në rastet e Bashkimit të Operatorëve Ekonomik:**

-Pika a) plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

-Pika b) duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur Operatorët ekonomik, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në Kontratën e Bashkëpunimit se cili prej tyre do ta përmbushë këtë kusht.

b) Për të vërtetuar përvojen e mëparshme Operatori Ekonomik duhet të paraqesë dokumentat e mëposhtme:

2.3.2 Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

a) Për kontrata të realizuara me ente publike, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr.9 (ku të përcaktohet qartazi vlera, afati i përfundimit të kontratës si dhe natyra e punës së kryer);
- Kontratë Sipërmarrje;
- Situacionin përfundimtar;
- Aktin e kolaudit;

- Çertifikatën e marrjes në dorëzim/Çertifikatën e Përkohshme të marrjes në dorëzim

b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr.9 (ku të përcaktohet qartazi vlera, afati i përfundimit të kontratës si dhe natyra e punës së kryer);
- Kontratë Sipërmarrje;
- Situacionin përfundimtar;
- Aktin e kolaudimit;
- Çertifikatën e marrjes në dorëzim/ Çertifikatën e Përkohshme të marrjes në dorëzim;

Operatori ekonomik ka paraqitur në SPE për plotësimin e këtij kriteri kontratat si më poshtë:

1. *Rehabilitimi dhe shtrimi me asfaltbeton te rruges se fshatit Dohoshisht Bashkia Diber 2022*
2. *Sistemim dhe asfaltim i rruges Belsh-Stanaj*
3. *Rikonstruksion i Rruges Rrase – Hysegjokaj, Pajalli, Beqiraj, Gradisht, (Faza e pare: Rikonstruksioni i Rruges Rrase-Pajalli)*
4. *Rikonstruksion dhe sistemim asfaltimi i rruges SHISH-Unaze, Bashkia Diber 2021*
5. *Rikonstruksion dhe mirembajtje te kanaleve vaditese te Njesive Administrative, viti 2023*
6. *Ndertim I minifushave ne shkollat 9-vjecare “Mark Dashi”, “Naim Frasheri”, “Jani Bakalli”, “Dino Ismaili”*
7. *Ndertim Rruget “Josif Mihali + rrugicat (Rruga pingul me Lidhja e Prizerenit + Jusuf Gervalla) + Llazo Palluqi + Llambro Andoni + Memo Meta*
8. *Ndertim rruga “Isa Boletini” Paskuqan I*
9. *Ndertim “Seg Lidhja e Prizerenit + Rruga “Lasgush Poradeci” + Rruga “Laze Shantoja” + Rruga “Lefter Talo” + Rruga “Lek Spiridoni”, Paskuqan I Koder”, Bashkia Kamez*
10. *Asfaltim i rruges Sanxhak (Rruga Artan Farka), Bashkia Kurbin*
11. *Asfaltim i rruges Sanxhak (Rruga Kampi), Bashkia Kurbin*
12. *Urbanizimi i bllokut te banimit ne lagjen Saver*
13. *Ndertimi i Parkut te ri te Qytetit, Bashkia Roskovec*
14. *Rikonstruksion ne DRSHTRR Diber....*
15. *Rehabilitimi i kanalit te ujrave te larta nelagjen Kongresi i Lushnjes*

Referuar rregullave të prokurimit publik, për kontratat për punë publike, për të provuar përvojën e ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të plotësojnë njërin prej dy kushteve të përcaktuara në nenin 39, pika 5 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, ku operatori ekonomik duhet të provojë se ka kryer punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës; ose të provojë se ka kryer punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Për përmbushjen e kriterit kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.1 të dokumenteve standarde të tenderit, për punime të ngjashme gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës operatori ekonomikë ankimes ka paraqitur dokumentacionin e cituar më sipër.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ndëkur dhe praktikat e ngjashme të KPP, gjykon të ndalet në një analizë të thelluar të dëshmimeve të eksperiencës së ngjashme të dorëzuar nga ana Operatorit Ekonomike, parë kjo në rrafshin krahasimor me preventivin dhe relacionin e specifikimeve teknike të autoritetit kontraktor, për sa i përket 3 komponentëve, si komponenti kohë (ku Komisioni për këtë komponentë do të marrë në konsideratë ato kontrata të cilat janë brenda afatit kohorë 5 vjeçar nga data e njoftimit të kontratës), komponenti vlerë (lidhet me madhësinë e kontratës ose kontratave të kërkuara nga autoriteti kontraktor në kriterin 2.3.1 pra për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 54 648 642.5 lekë pa TVSH apo vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se 218 594 570 leke Pa tvsh , si dhe komponentit natyrë e ngjashme (i cili lidhet me natyrën e ngjashme të kontratave të dorëzuara nga operatori ekonomikë me objektin e prokurimit nisur jo vetëm nga emërtesa e kontratës por edhe nga zërat e preventivave të tyre).

Nga shqyrtimi dhe verifikimi i të gjitha elementeve të kontratave të sipërcituara, duke nisur që nga objekti i tyre, vërtetimi i realizimit (si dokument i përcaktuar në kriter për vërtetueshmërinë e punëve

të ngjashme), përshkrimi i punimeve në situacion si pjesë përbërëse e kontratave, si dhe afatit të realizimit të tyre, nga të gjitha kontratat e dorëzuara në sistemin e prokurimeve elektronike Komisioni i Vleresimit të Ofertave konstaton se, ky i fundit nuk përmbush kushtin e parë të vendosur nga autoriteti kontraktor për të paraqitur dokumentacion për punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 54 648 642.5 lekë pa TVSH, që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, kështu që rrjedhimisht verifikoi dokumentacionin e dorëzuar në SPE nga operatori ekonomik "2N" SHPK për plotësimin e kushtit të dytë "dokumentacion për punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se 218 594 570 leke Pa tvsh. Nga shqyrtimi dhe verifikimi i të gjitha elementeve të kontratave të sipërcituara, duke nisur që nga objekti i tyre, vërtetimi i realizimit (si dokument i përcaktuar në kriter për vërtetueshmërinë e punëve të ngjashme), përshkrimi i punimeve në situacion në analiz të objektit e prokurimit nisur jo vetëm nga emërtesa e kontratës por edhe nga zërat e preventivave të tyre si dhe afatit të realizimit të tyre, nga të gjitha kontratat e dorëzuara në sistemin e prokurimeve elektronike nga operator ekonomikë "2N" shpk, për vërtetueshmërinë e përmbushjes së kriterit të përcaktuar në pikën 2.3.1/b të dokumenteve standarde të tenderit konstatohet se operatori ekonomik nuk ka kryer punime të ngjashme me zërat në preventivin e hartuar nga autoriteti kontraktor për këtë procedurë prokurimi. Nga një analizë e realizuar në lidhje me zërat e punimeve në Preventiv/Situacion Perfundimtar të punëve të ngjashme të paraqitura nga operatori 2N shpk, rezulton se nuk janë të ngjashme në tipologjinë ujesjelles (Tuba ujesjellesi PE, Saraqineska, rakorderi elektrofuzive, matesa uji, etj.) me zërat e preventivit të objektit të kërkuara nga autoriteti kontraktor.

Rrjedhimisht kriteri 2.3.1 nuk do të konsiderohet i përmbushur nga operatori ekonomik "2N" shpk, dhe do të s'kualifikohet.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **"BALILI KONSTRUKSION" SHPK**, me NIPT **K17016202S** Me Adrese Vlore, Velce, me Subjekt Mbështetës **ED KONSTRUKSION" SHPK**, me **K61625001I** se oferta e paraqitur me vlerë totale prej **99.908.465.16** (nentedhjete e nente milion e nenteqind e tete mijë e katerqin e gjashtedhjete e pese pike gjashtembedhjete) lekë pa TVSH, është identifikuar si ofertues i sukseshëm.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR
Gentian Alik